

Udhezime per perdorimin

Kuadri ligjor per certifikimin dhe tregtimin e produkteve Bio ne funksion te zhvillimit te qendrueshem dhe te mbrojtjes se mjedisit

Prof. As. Dr. Andon Kume

Aleksandër Moisiu University of Durrës, Albania

Ky material mesimor eshte konceptuar per studente te drejtesise te programit master dhe/ose te programit bachelor. Materiali eshte konceptuar si pjese e praktikës se kursit mbi te drejten e mjedisit duke qene se ka per objekt te tijin produktet organike te cila ndihmojne ne ruajtjen e mjedisit.

Faza 1: Ceshtja do te diskutohet me studentet e drejtesise duke u fokusuar ne menyre te pergjithshme ne strumentat e ndryshem qe mund te perdoren per mbrojtjen e mjedisit dhe ne vecanti ne ato strumenta qe mund te ndikojne ne zhvillimin e qendrueshem.

Faza 2: Studentet do te marrin pjese ne nje leksion te hapur gjate te cilit do te lektrojne perfaqesues te Shoqates Bio-Adria dhe nje fermer i zones se Durresit qe prodhon rrush bio. Ky leksion do te kete per qellim familjarizimin e studenteve me rolin e fermave bio ne mbrojtjen e mjedisit dhe ne zhvillimin rural te qendrueshem nepermjet prezantimit te rasteve praktike te fermave bio si dhe literatures boterore ne kete fushe.

Faza 3: Studentet do te prezantohen me rregullat shqiptare per prodhimin etiketimin dhe marketimin e produkteve organike dhe perfitimin e subvencioneve nga ana e shtetit.

Faza 4: Ne kete faze do te formohen grupet e studenteve (4-5) te cilet pasi te kene perzgjedhur nje produkt te caktuar do te pergatisin mbi te nje dokument qe do permbaje instruksionet kryesore per prodhimin e ketij produkti ne menyre organike dhe gjithe dokumentacionin e nevojshem per certifikimin, marketimin dhe perfitimin e subvencioneve te shtetit per kete produkt.

Ne fund te kursit studentet do te prezantojne punen e tyre dhe rezultatet e arritura. Se bashku do te vendoset se si do te shperndahen dhe promovohen rezultatet e arritura. Disa nga strumentat qe mund te perdoren per kete qellim mund te jene:

- a. Publikime te detyrave te kursit ne mediat sociale si facebook;
- b. Publikim ne faqen e internetit te universitetit